

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lala: Rregullorja e GJKKO-së cenon median, çështja mund të shkojë në Strasburg
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/lala-rregullorja-e-gjkkko-se-cenon-median-ceshtja-mund-te-shkoje-ne-st-i104054
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 15:00:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	86efabf56dd721895d3473888d825f6934a3d16d8630753ad9bf2b3089383e11
TEKSTI	374efcc74268f188a237a05cd5d13e640c5d96c7d022d4174f9a9447881911d2
PAMJA	b67c838fd3b095e1ae57d3ace8c9f9918818014ed39c6ddf93a52ebf0efe4f7b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c39c4dff7d2c7be97660c9fd7b21bab33660fe92c9ae8a35d620de1647c6292c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e0b9829abbbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67ff94e9a06c82fe2c5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c39c4dff7d2c7be97660c9fd7b21bab33660fe92c9ae8a35d620de1647c6292c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [te macronit](#)

■ [fëmijë, shkolla](#)

■ [Këtë 14 shtator dyert e shkollës](#)

■ [shkollë e](#)

■ [NUK ka pasur loitar](#)

■ [ka dyer heshtjen në një intervistë](#)

■ [Koçeku: politike nga subjekte](#)

■ [pezum detyra efektive](#)

AKTUALITET

Lala: Rregullorja e GJKKO-së cenon median, çështja mund të shkojë në Strasburg

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 16:46



Gazetarja Klodiana Lala e ka cilësuar si censurë rregulloren e re të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për raportimin e medias. Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë iu drejtua sot Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin dhe shfuqizimin e dispozitave që prekin punën e gazetarëve.

Në një intervistë për News24, Lala deklaroi se rregullorja e re bie ndesh me ligjin dhe Kushtetutën. Sipas saj, kërkesa për akreditimin e gazetarëve përplasat me parimin që seancat gjyqësore duhet të jenë publike, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Gazetarja vuri në dukje gjithashtu se rregullorja hyn në fuqi në një periudhë kur disa figura të politikës janë në proces gjykimi, ndërsa të tjera pritet të përballen me gjykatën.

Duke folur për masat e sigurisë që zbatohen aktualisht për hyrjen në ambientet e gjykatës, Lala tha se gazetarët u nënshtrohen disa niveleve të kontrollit dhe se seancat regjistrohen në sistemin audio.

“Ne kontrollohemi në hyrje nga garda. Lëmë çantat, kalojmë në skaner. Kalojmë skanerin e dytë dhe më pas kemi kontroll fizik nga një punonjëse e autorizuar nga ligji, që kontrollon vajzat dhe gratë dhe një punonjës mashkull që kontroll burrat. Pra ka një sistem sigurie të sofistikuar. Të gjithë seancat janë të regjistruara në sistemin audio.

Pra do të thotë se kjo rregullore që ka miratuar zoti Erjon Bani, që është administrative që nuk është përfaqëuar nga Gjykata e Apelit të Posaçëm, bie ndesh me ligjin, kërkon akreditimin e gazetarëve ndërkohë që ligji dhe kushtetuta thonë se seancat janë publike përveç se në rastet kur ligji parashikon të kundërtën. Ne nuk lejojmë të kemi një celular. Gjë tjetër që përbën problematikë është akreditimi. Formulari kërkon adresën e shtëpisë. E dhënë e panevojshme.”, tha ajo.

Një tjetër pikë të rregullores që Lala e kundërshtoi lidhet me kërkesën që gazetarët të betohen se do të thonë të vërtetën. Sipas saj, një kërkesë e tillë është e papërshtatshme, pasi gazetarët nuk janë dëshmitarë në procesin gjyqësor.

“Tjetër skandal i madh është se gazetari duhet të betohet se duhet të thotë të vërtetën. Ne nuk jemi dëshmitarë të gjykatës”, shtoi ajo.

Lala paralajmëroi se çështja mund të dërgohet deri në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, nëse kërkesa e gazetarëve nuk merr zgjidhjen e pretenduar prej tyre në Gjykatën Kushtetuese.

“Nëse këtë fitore se marrim në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të ndikohet, jam e bindur se e drejta jonë mund të fitohet në Gjykatën e Strasburgut.”, tha ajo.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator16:11

[Nuk u kthye në burg pas lejes, arratiset Alket Rizai në Greqi, shpallet në kërkim](#)

Alket Rizai është rikthyer sërish ndër emrat më të kërkuar nga policia në Greqi. Lejen e marrë nga burgu i Domokos ...

AKTUALITET 14 Shtator15:54

[Gazetari Osman Stafa u kërcënua përmes mesazheve në rrjetet sociale, policia nis punën për kapjen e autorit](#)

Gazetari Osman Stafa ka kallëzuar në polici se ka marrë një mesazh kërcënues në llogarinë e tij në ...

AKTUALITET 14 Shtator15:45

[SafeJournalists: Kërcënimi me vdekje ndaj gazetarit Osman Stafa në Shqipëri duhet të hetohet urgjentisht](#)

Rrjeti SafeJournalists dënon fuqishëm kërcënimin e drejtpërdrejtë me vdekje ndaj gazetarit të News24, Osman St...

AKTUALITET 14 Shtator15:16

[Ilir Meta del nga kafazi i qelqtë/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit](#)

Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e kreut të Partisë së Lirisë, Ilir Meta, për të dalë nga kafazi i qelqtë ...

AKTUALITET 14 Shtator15:14

[Kontroll blic me urdhër të SPAK-ut në sektorin ku mbahet Ergys Agasi. Gjenden pajisje wireless dhe alkool!](#)

Një kontroll blic është urdhëruar nga SPAK, për kontrolle të imtësishme në paraburgimin e Bradasheshit në sekt...

AKTUALITET 14 Shtator15:00

[Goditi me grusht në bark qytetarin, Skender Hita pezullon nga detyra efektivin e “Shqiponjave”](#)

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skender Hita, ka reaguar pas publikimit të një videoje ku shfaqet një punonj...

Piranjat News AKTUALITET 14 Shtator14:23

[Aksidenti në lagjen “18 Shtatori” Gjirokastrë, policia asnjë masë](#)

Një tjetër aksidenti është shënuar sot në lagjen “18 Shtatori” në Gjirokastrë. Një automjet ka dal&eum...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 14 Shtator14:15

[A do të mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë](#)

Përmes 5 procedurave tenderuese të hapura në Ditën e parë të Shkollës, kryetari i bashkisë Fier, Armando Subashi, i ka...

AKTUALITET 14 Shtator13:37

[SPAK me kërkesë të re për arrestimin e Ballukut? Berisha: Ka tension real mes Ramës dhe Lubisë! Dora e zezë e saj qëndron pas...](#)

Kreu i PD-së, Sali Berisha, është pyetur nga gazetarët në lidhje me mundësinë që SPAK të dërgojë në...

AKTUALITET 14 Shtator13:21

[“Do të vras, këtë ta garantoj”/ Kërcënohet me vdekje gazetari Stafa, AGSH kërkon hetim](#)

Gazetari i News24, Osman Stafa, është kërcënuar me vdekje përmes një mesazhi të dërguar në llogarinë e tij n...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...](#)


Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!






Reagon Cilevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.